



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT**

**PROGRAM TRAJNIMI**

**Muaji Dhjetor 2021**

Referuar Plan-Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 14 datë 08.02.2021, gjatë muajit Dhjetor 2021, do të zhvillohen trajnimet si më poshtë:

- **Fokusi i trajnimit:** Mbi njohjen e përditësimeve të Manualit të Auditimit IT dhe Standarteve Ndërkombëtare mbi Teknologjinë e Informacionit.

Nr.	Tema	Trajnuesit
1.	Manuali i Auditimit IT	<b>Benard Haka,</b> Kryeauditues Departamenti i Auditimit IT. <b>Edukimi: Ing. Telekomunikacioni</b>
2.	Standartet Ndërkombëtare mbi Teknologjinë e Informacionit.	<b>Elira Cukalla</b> Audituese e Lartë Departamenti i Auditimit IT, <b>Edukimi: Informatikë</b>  <b>Klea Saliu:</b> Audituese e II (e dytë) Departamenti i Auditimit IT, <b>Edukimi: Ing. Telekomunikacioni</b>

**Target grupi:** Departamenti i IT-së dhe me përzgjedhje, auditues në departamente auditimi. Trajnimi do të organizohet në dy ditë.

**Kalendari i realizimit të trajnimeve:**

**Muaji Dhjetor, 2021**

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

- Nga data 06-07 Dhjetor, përgatitja e Programit të trajnimeve;
- Nga data 09-10 Dhjetor, përgatitja e temave nga trajnuesit;
- Nga data 16-17 Dhjetor, zhvillimi i trajnimeve.

- **Kohëzgjatja e trajnimit:** Trajnimi do të shtrihet në 2 ditë sipas skedulimit të mëposhtëm.

### Kalendari i trajnimit

Nr.	Departamentet	Trajnerët	Data	Orari
1	Departamenti i Auditimit të IT-së; Auditues të përzgjedhur nga stafi Drejtues, në Departamente Auditimi	Benard Haka	16.12.2021.	11.00-12.30
2	Departamenti i Auditimit të IT-së; Auditues të përzgjedhur nga stafi Drejtues, në Departamente Auditimi	Elira Cukalla Klea Saliu	17.12.2021.	11.00-12.30

#### Elementët e trajnimit:

- Skedulimi
- Zhvillimi
- Kontrolli
- Vlerësimi

#### **Që të realizohet një proces trajnimi optimal, duhet të plotësojmë disa kushte:**

- Sigurimi i teknikës së nevojshme: Trajnimi do të zhvillohet online, nëpërmjet Platformës “Microsoft Skype”. Trajnerët para orës së trajnimit duhet të dërgojnë me email, të gjithë audituesve të përcaktuar për të ndjekur trajnimin, linkun ku do të aksesojnë;
- Sigurimi i materialeve të nevojshme: Të gjithë audituesit, kanë akses të plotë mbi materialet të cilat do të jenë objekt i këtij trajnimi. Standardet, rregulloret, udhëzues, ligji organik i KLSH-së etj., janë të publikuara në faqen web të KLSH-së.
- Sigurimi i trajnerëve të aftë: Nga lista e trajnerëve janë përzgjedhur trajnerë, të cilët kanë kompetencën e duhur profesionale në drejtimet përkatëse të trajnimit.

**Skedulimi i programit:** Skedulimi i programit është bërë duke patur në konsideratë ngarkesën në punë të audituesve, Zhvillimi online është një lehtësi, pasi ndjekja e trajnimit mund të kryhet nga vendet e punës, pa prezencë fizike. Trajnimi shtrihet në 2 ditë, me fokus në njohjen e përditësimeve të Manualit të Auditimit IT dhe Standarteve Ndërkombëtare mbi Teknologjinë e Informacionit.

Në etapën e zhvillimit të trajnimit ndikojnë disa faktorë:

- Përzgjedhja e platformave të ndryshme on-line;
- Përgatitja e lektorëve, sa ata e bëjnë tërheqës trajnimin;

- Përgatitja dhe interesi i pjesëmarrësve, sa ata kanë interes rreth çështjeve që trajtohen, kjo është e lidhur ngushtë me etapën e parë të këtij procesi me përcaktimin e nevojave dhe sa janë të përgatitur pjesëmarrësit.

**Kontrolli:** Gjatë procesit të zhvillimit të trajnimit është e rëndësishme që në mënyrë permanente të ndiqet sa është realizuar dhe si janë realizuar objektivat që janë programuar për t'u realizuar. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet disa mënyrave:

- Testimi i reagimit të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të trajnimit, kjo nuk teston njohuritë e tyre, por mund të vlerësojë pozitivisht interesin e tyre, për çështje të veçanta dhe vlerësimin për trajnerë të veçantë;
- Testimi i njohurive, në fund të zhvillimit të seancave për çështje të caktuara;
- Shembuj konkretë duke punuar në grupe të vogla, vlerësimi i tyre;
- Debateve dhe konkluzioneve në fund të çdo seance, etj.

**Vlerësimi i trajnimit:** Vlerësimi i trajnimit është etapë me rëndësi, pasi mbledh të dhënat e nevojshme për të përcaktuar nëse procesi i trajnimit ishte i efektshëm.

Vlerësimi i programi i trajnimit: *(Plotësimi i pyetësorit të përgatitur nga trajnuesit, nga ana e audituesve, pjesëmarrës në trajnim)*

- Për të përcaktuar nëse trajnimi ka kontribuar në arritjen e qëllimeve të auditimit;
- Për të vlerësuar si dhe sa, të trajnuarit perfeksionuan njohuritë e tyre në këtë proces trajnimi;
- Për të vlerësuar metodat e përdorura në trajnim, nëse ato e ndihmuan të trajnuarin në arritjen e objektivave të trajnimit.
- Për të dizajnuar sa më mirë trajnimin e ardhshëm duke vlerësuar se ku ishin të metat dhe dobësitë e trajnimit të kryer.
- Për ta bërë në këtë mënyrë trajnimin një mjet sa më efikas
- Për të justifikuar koston e trajnimit, pasi KLSH investon në mënyrë që të përfitohen avantazhet e programuara.

**Drejtore**

**Brunilda Zeneli**

**MIRATOI**

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Mariola LLANAJ**

